

Vendim nr. 226 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KRESHNIK HAXHIAJ**, përfaqësuar nga avokat Alban Qafa, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2018-191, datë 25.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 18, 30, 31, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 145 e në vijim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 34 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 3 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë; nenet 432 dhe 434 të Kodit të Procedurës Penale; nenet 28, 29, 30 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është shtetas shqiptar. Ai ka qenë i shpallur në kërkim ndërkombëtar në bazë të urdhrit të arrestit DKRP 210/2016, datë 28.12.2016 të Gjykatës Themelore Pejë, Kosovë, si i dyshuar për veprat penale “Vrasje e rëndë”, “Bashkimi kriminal për të kryer vepër penale të vrasjes” dhe “Posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Në bazë të këtij urdhri kërkimi ndërkombëtar, në datën 26.07.2017 oficerët e Policisë Gjyqësore të Komisariatit të Policisë së Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” kanë bërë arrestimin e përkohshëm të kërkuesit, me qëllim ekstradimin e tij në Kosovë dhe në vijim, për të njëjtin qëllim, ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, sipas vendimit nr. 1628 të regjistrimit themeltar, datë 29.07.2017.

2. Pas njoftimit të autoriteteve të drejtësisë kosovare për arrestimin e përkohshëm të kërkuesit, ato paraqitën në vijim kërkesën për ekstradimin e tij, duke parashtruar edhe se urdhri i arrestit vijonte të ishte në fuqi, çështja penale në themel kundër kërkuesit ishte duke u rigjykuar dhe se ndjekja penale ndaj tij nuk ishte parashkruar. Këtë kërkesë Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ia ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ia ka dërguar atë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit në datën 01.08.2017 ka paraqitur kërkesë për lejimin e ekstradimit të kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës. Me vendimin nr. 1182, datë 25.09.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Kosovës. Ky vendim, pas ankimit të kërkuesit, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 267, datë 07.02.2018, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2018-191, datë 25.04.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Në datën 19.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuessit

4. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:
- 4.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *së drejtës për t'u mbrojtur me avokat të zgjedhur dhe liria personale*, pasi është mbajtur i paraburgosur deri në ekstradimin në Kosovë për një vepër penale për të cilën ishte gjykuar nga organet e drejtësisë kosovare dhe kishte marrë pafajësi edhe pas rigjykimit të çështjes. Ndaj tij është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, megjithëse nuk ekzistonin kushtet e flagrancës dhe gjykata e apelit e ka zhvilluar gjykimin me një avokat të caktuar kryesisht, ndonëse ai kishte zgjedhur avokat të pajisur me akt përfaqësimi.
- 4.2. *E drejta për të mos u dëbuar*, pasi është ekstraduar ndonëse nuk u është fshehur organeve të drejtësisë kosovare, ndërsa ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe në apel është përfaqësuar me avokat, ndërkohë që gjykata kosovare nuk e ka njoftuar në adresën e tij të banimit në Shqipëri.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

5. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

7. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të evidentojë fillimisht se kërkuesi në objektin e kërkesës ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin e themelit të ekstradimit, ndërkohë që në përmbajtje ka kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë vendosur për paraburgimin e tij për qëllime ekstradimi.

8. Nisur nga kjo, për pretendimet e kërkuesit ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme që kanë vendosur për paraburgimin e tij për qëllime ekstradimi, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Në lidhje me këtë kriter legjitimiteti, Gjykata ka pohuar se, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2022; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Si përjashtim, Gjykata ka vlerësuar se vendimet që lidhen me masën e sigurimit të arrestit me burg, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në kërkesën e tij kërkuesi ka parashtruar se paraburgimi i tij është vendosur me vendimin nr. 1628 (regjistri themeltar), datë 29.07.2017 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe se ai ka paraqitur ankim, i cili është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, por pa iu garantuar e drejta për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur nga ai. Bashkëlidhur kërkesës ai ka paraqitur vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por jo vendimin e gjykatës së apelit. Pavarësisht kësaj, referuar përmbajtjes së rekursit të paraqitur nga ai kundër vendimit të gjykatës së apelit në çështjen e themelit të ekstradimit, rekurs i cili i është bashkëlidhur kërkesës, kërkuesi ka parashtruar edhe se ankimi i tij ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për caktimin e masës së sigurimit personal është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në datën 07.08.2017, por se ankimi i tij nuk është pranuar me arsyetimin se është bërë jashtë afatit ligjor, ndërkohë që atë vendim ai nuk e ka marrë ende, duke iu cenuar e drejta për rekurs. Pra, referuar kërkesës, por edhe akteve bashkëlidhur asaj, më së paku, nuk rezulton që kërkuesi të ketë përdorur në formë dhe substancë mjetet e zakonshme të ankimit, pikërisht rekursin në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u mbrojtur me avokat të zgjedhur dhe të lirisë personale në lidhje me vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë vendosur për paraburgimin e tij për qëllime ekstradimi.

10. Në vijim, për pretendimet e kërkuesit ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme që kanë vendosur për ekstradimin e tij, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr.8577/2000, sipas të cilit kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit, afat të cilin, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur nga vendimi i organit gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor.

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi që ka përmbyllur procesin gjyqësor është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 25.04.2018, ndërsa ankimi kushtetues individual nga kërkuesi është paraqitur në datën 19.05.2025, pra pas më shumë se 7 vjetësh. Në ankimin e tij individual kërkuesi ka parashtruar se kërkesa paraqitet brenda afatit ligjor 4-mujor, duke e llogaritur atë nga data 15.01.2025, kur, sipas tij, ka marrë dijeni për vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të tij, pas interesimit të avokatit në sekretarinë gjyqësore të asaj gjykate dhe marrjen prej saj të kopjes së vendimit.

12. Kolegji vëren se pavarësisht nga sa kërkuesi parashtron në lidhje me ardhjen në dijeni të vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ai pranon se në kohën përkatëse,

ndërsa vijonte të ishte i paraburgosur, është ekstraduar në Republikën e Kosovës. Nisur nga një rrethanë e tillë, duke mbajtur në konsideratë edhe se kërkuesi në procesin gjyqësor të kundërshtuar është mbrojtur me avokat, sikundër edhe faktin se sipas ligjit procedural penal, nenit 462, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, vendim i ekzekutueshëm në rastet e ekstradimit është vendimi i Gjykatës së Lartë dhe se Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda 30 ditëve nga data që vendimi i gjykatës merr formë të prerë, përndryshe personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet (neni 499, pika 1), Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mungesën e dijenisë deri në datën 15.01.2025 për vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk mund të pranohet. Përcaktimi ligjor se ekstradimi mund të ndodhë vetëm nëse në favor të tij është shprehur Gjykata e Lartë (kuptohet nëse është paraqitur rekurs), pasja nga kërkuesi e një avokati të zgjedhur dhe ndodhja në fakt e ekstradimit të tij në Republikën e Kosovës, janë rrethana që logjikisht bëjnë të papranueshëm pretendimin e kërkuesit për padijeninë e shqyrtimit të rekursit dhe gjetjen e tij të pabazuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në kohën përkatëse kur ekstradimi ka ndodhur. Ndonëse aktet bashkëlidhur kërkesës janë tepër të kufizuara, edhe në supozimin e mungesës së një akti formal për njoftimin e vendimit të atij kolegji, koha e gjatë që ka kaluar nga dhënia e vendimit nuk mund të justifikojë mungesën e kujdesit dhe të veprimit në kohë nga ana e kërkuesit dhe avokatit të tij për kundërshtimin e procesit gjyqësor që ka vendosur për ekstradimin. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk plotëson kriterin e legjitimitetit *ratione temporis* për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u dëbuar në lidhje me vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Kosovës.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.